



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 2/17
Prishtinë, më 17.10.2017, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontiq, Dardan Molliqaj, Ali Lajçi, Mytaher Haskuka, Naser Osmani, Mërgim Lushtaku, Blerim Kuqi, Enver Hoti dhe Myfera-Serbica Sinik,

I ftuar dhe pjesëmarrës: Bedri Hamza, ministër i Financave.

Stafi mbështetës i Komisionit: Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Kryetar i Komisionit – Lumir Abdixhiku.

Rendi i ditës

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-002, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2017;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari – Rendi i ditës është shpërndarë me kohë dhe propozoj miratimin e tij.

Dardan Molliqaj – E kam një kërkesë, nëse mundet administrata t'na sjellë nga një kopje të rendit të ditës.

Kryetari – Sa për informim, rendi i ditës është shpërndarë me kohë në kutitë tuaja postare në Kuvend.

Kryetari, konstatoi se rendi i ditës u miratua njëzëri pa ndryshime.

2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-002, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2017;

Kryetari - Projektligji nr. 06/L-002, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2017 është proceduar nga Qeveria në Kuvend, në pajtim me procedurat ligjore në fuqi, dhe ne si komision jemi të ngarkuar që ta shqyrtojmë në parim dhe t’ia paraqesim Kuvendit Raportin me rekomandime.

Bedri Hamza - Qeveria e Kosovës me marrjen e mandatit është ballafaquar me mungesë alokimesh në shumë linja buxhetore, të cilat kanë bërë të domosdoshme procesin e rishikimit të buxhetit 2017. Qeveria ka nis procesin e rishikimit, duke marrë për bazë trendin real të shpenzimeve dhe të hyrave buxhetore. Proceset buxhetore duhet të bazohen vetëm në vlerësime reale për të siguruar mbarëvajtjen e stabilitetit makro-fiskal. Vlera totale e shpenzimeve me këtë rishikim është 1 miliardë e 805 milionë euro, ndërsa të hyrat buxhetore janë planifikuar 1 miliardë 725 milionë euro.

Rishikimin e buxhetit kemi arritur të harmonizojmë dhe të njëjtin e kemi diskutuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar, duke e ruajtur deficitin e shënueshëm. Bilanci bankar në fund të vitit planifikohet të jetë rreth 4.8% të BPV-së, respektivisht 300.3 milionë euro. Jemi kujdesur që kredibiliteti buxhetor dhe shtetëror të ruhen konform obligimeve ligjore dhe kontraktuale. Rishikimi i buxhetit adreson ndër të tjera edhe: sigurimin e fondeve të mjaftueshme për kategorinë e veteranëve të luftës sipas ligjit në fuqi që është një shumë prej rreth 26 milionë euro, pagesat e detyrimeve në kohë për autostradën “Arbër Xhaferi”, me një shumë prej 50 milionë euro, sigurimin e fondeve për organizimin e zgjedhjeve, në shumë prej 2 milion euro, pagesën e detyrimeve financiare nga vendimet e prera të gjykatës në shumë prej 5.6 milion euro, mbulesën financiare për obligimet ligjore për RTK-në prej 1.4 milion euro, mbështetjen financiare për Këshillin Prokurorial të Kosovës, financimin e nevojave brenda misioneve tona diplomatike, si dhe një numër të madh për funksionim adekuate të institucioneve tona, në shumën prej 5.4 milion euro. Në total vlera për kërkesa për financim shtesë kalon shumën mbi 90 milionë euro.

Në kohën e shpejtë kemi zhvilluar një proces të konsultimeve me organizatat buxhetore të nivelit qendror dhe kemi arritur që nevojat për financim shtesë t’i mbulojmë me kurse. Kemi arritur që në buxhetin origjinal të zbrisim edhe me tutje disbalancat në mes të hyrave dhe shpenzimeve, duke ulur deficitin dhe duke treguar përkushtimin tonë të disiplinuar për financat publike.

Me anë të rishikimit të buxhetit, përveç adresimit të mungesave për financim, po mundësojmë një numër të madh harmonizimesh buxhetore brenda organizatave buxhetore përmes rialokimeve që sigurojnë zotim me efikas të buxhetit. Po ashtu, më duhet të theksoj se me buxhetin origjinal kemi një vlerë mjaft domethënëse por plotësisht të paspecifikuare të pranimit nga financimi prej fondeve të AKP-së dhe huamarrjes së huaj, ndërsa me këtë rishikim duhet ta pasurojmë situatën reale.

Kryetari – Nuk e di sa ka qenë praktikë në rishikimet e kaluara, por kemi një buxheti që nuk ka lidhje pjesa tekstuale me pjesën makroekonomike dhe me projeksionet e tilla më duken më shumë si një dokument kontabiliteti se sa buxhet shtetëror. Dëshirojë të dijë këta muajt e mbetur, cilat janë projeksionet makroekonomike që ndërlidhen me ndryshimet buxhetore dhe çfarë efekti ka një buxhet i tillë. E dyta, kam një pyetje rreth Marrëveshjes për Programin që kemi me FMN-në, kur pritet të kthehemi me program? Si reflekton kjo marrëveshje si rezultat i zvogëlimit të fondeve të shërbimeve shëndetësore, pasi që kam informacione se këto kanë qenë pjesë e kontraktuar me Marrëveshjen me FMN-në dhe këto fonde janë larguar me rishikimi? Çështja tjetër lidhet me zvogëlimin e investimeve kapitale prej 240 milionë euro: nga grandet 21 milionë euro, 103 milionë euro janë zvogëluar nga klauzola investive, 87 milionë euro nga fondet e likuidimit të AKP-së. Çështja e fundit ka të bëjë me pagesën e veteranëve dhe për këtë çështje kam dy pyetje: e para, kur pritet të bëhet seleksionimi i

veteranëve dhe e dyta a ka implikime ligjore të ndërlidhura me Ligjin për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për veteranët e luftës, kur theksohet se shumica e ndarë do të kalojë 0.7% e BPV-së.

Dardan Molliqaj – Ajo që shihet në fillim në këtë projektbuxhet është problematike për mënyrën se si është rishikuar ky projektbuxhet. Ajo që është dashur Qeveria me na sjellë një listë se cilat projekte janë hequr me këtë rishikim dhe mendoj që kjo është bërë me qëllim që mos të jetë e qartë dhe ne të mos kemi mundësi të shohim se çfarë po heqin dhe çfarë po shtohet, prandaj edhe është propozuar kështu me shifra e kolona. Mua më duket krejtësisht joserioze rishikimi i buxhetit, i cili prek vetëm shpenzimet dhe jo të hyrat. Ky rishikim ka probleme të mëdha. E para tregon se qeveria aktuale nuk është serioze dhe është ngutur pasi që është e pamundur të parashikohet realizimi 100% në fund të vitit, siç janë planifikuar dhe kjo është bërë ose që nuk kanë dashur ose nuk kanë ditur apo është bërë për qëllime tjera.

E dyta, është më shumë për qeverinë e kaluar dhe buxheti i planifikuar në fillim prej 2 miliardë euro ka qenë më shumë fiksuar për opinionin publik dhe për fushatë se sa realitet, sepse të njëjtit partnerë të koalicionit menjëherë tash e rishikojnë buxhetin dhe po e zvogëlojnë diku afër 190 milionë euro. Një pyetje që dëshirojë ta bëjë është fakti se është fshirë komplet projekti për autostradën në Gjiçan. Në dokument nuk po e shoh këtë projekt? Nëse është fshirë, kjo po i bie se është bërë për qëllime të fushatës dhe po i bie se dikujt nuk po i dalin llogaritë në ndonjë komunë. Ndërkaq, kur po i dalin llogaritë po e lënë buxhetin pak a shumë sikur ata milionat kur i shpërndante Thaçi, kur ishte kryeministër. Po ashtu, edhe tani me autostrada po luhet njëjtë për shkak se këto ditë e pash kryeministrin e Kosovës në një tubim elektorale, ku tha se do ta ndërtojë autostradën në drejtim të Pejës dhe do të kryhet pa ra bora e parë, që nuk është serioze.

Ne po shpenzojmë vazhdimisht pjesën më të madhe të investimeve kapitale në autostrada dhe unë asnjëherë nuk e pash një përlllogaritje apo një tekst të shkruar siç tha edhe kryetari i Komisionit, se çfarë efekti kanë në ekonomi këto investime? Ne kemi nevojë për investime në shumë fusha dhe sektorë me elementarë. Ne kemi probleme elementare me ujë të pijshëm, dhe shumica e Kosovës nuk ka kanalizim, lumenjtë janë të ndotur komplet, shumica e qendrave të mjekësisë familjare përveç në Prishtinë nuk kanë as ujë. Ne po investojmë paratë në autostrada të cilat nuk po kthehen në zhvillim ekonomik, ndërsa njerëzit tanë po vuajnë për nevoja elementare. Kështu që, ministri t'na sjell një raport sa më shpejtë që ti sqarojë këto çështje të ngritura. Me këtë rishikim krejt çka ka ndodhur është që janë zvogëluar investimet kapitale, ndërsa janë rritur shpenzimet rrjedhëse dhe përderisa në vitin 2016, kanë 203 milionë euro, tash kemi një kufi prej 225 milionë euro.

E pashë se një prej shpjegimeve janë dënimet për afëra korruptive të pasaportave e dëmet që po ja bënë qeverisja e PDK-së dhe na po duhet me i pagua, pra është fjala për 5.8 milion euro nga vendimet e gjykatave. Por nuk e morra vesh shumën prej 20 milionë euro, për cilat dënime tjera bëhet fjalë dhe duhet shpjeguar këtë më mirë? Sa i përket buxhetit të RTK-së a është rritur dhe pse është rritur?

Kryetari – Çështja e rishikimit të buxhetit është e kësaj qeverie dhe pse nuk arrijnë ta bëjnë 2 miliardë euro, përgjegjësinë e mbajnë këta, e edhe shkurtimi investime kapitale është rezultati i kësaj.

Naser Osmani - Kjo qeveri i bënë prioritete e veta edhe ky ndryshim e ka pak këtë kuptim të rregullimit nga ajo që ka qenë. Unë mendoj se vlerësuar në aspektin institucione-shtetërorë, situata është pozitive dhe i shoh që të hyrat e rregullta nga agjencitë kryesore të të hyrave, siç janë doganat dhe ATK-ja, por edhe të hyrat tjera janë ashtu siç kanë qenë deri më tani. Investimet kapitale kanë rënë për 190 milionë e 888 euro, për shkak se nuk kemi, nuk po arrijmë mjetet sipas klauzolës së investimeve dhe nuk jemi në gjendje nga institucioni t'i marrim dhe përdorim për interesat tona të përgjithshme.

Një gjë e mirë që shoh këtu është fakti se deficiti buxhetor është i përballueshëm. Është për keqardhje që rishikimi buxhetit vjen në këtë kohë dhe po shihet se është menduar të mbulohen disa obligime kontraktuale si 50 milionë euro për Bektel Enkën sepse gjërat janë shumë të mëdha dhe ndonjë pagesë tjetër si urgjencë. Anë pozitive është se nuk janë prek investimet kapitale të komunave e as investimet

për bashkëfinancim, por është brengosëse ajo që është prek mjaftë shumë kategoria e veteranëve të luftës që arrin dukshëm shpenzimet rrjedhëse që shkon diku 70% të të hyrave buxhetore. Kjo është një problematikë shumë e madhe dhe nuk kemi fuqi politike as gatishmëri politike ta rregullojmë këtë çështje dhe kjo është arsyeja që i kemi humbur 103 milionë euro. Po investohen 65 milionë euro për këtë kategori dhe kam frikën ashtu siç kemi diskutuar edhe me FMN-në se kjo mund të shkojë deri në 90 milionë euro.

Investime të mëdha kemi bërë në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore dhe është dashur rritje vite të tëra, që të hyjë në fuqi dhe i kemi ndarë 17 milionë euro, që të hyjë në funksion dhe ne e dimë se Kosova humb miliona shërbime jashtë Kosove dhe nuk jemi në gjendje ta rregullojmë asnjëherë këtë çështje dhe nga ndarjet buxhetore po shihet se përsëri do të vonohemi në zbatimin e Ligjin për shëndetësi.

Kemi nevojë për disa sqarime, pse i jepen autostradës për Mitrovicë 8.9 milion euro, a do të thotë se nuk jemi në gjendje me e përfundu këtë projekt apo nuk kemi obligime kontraktuale apo për qëllime tjera? Çështja e heqjes së autostradës për Gjilan, rruga e Skenderajt, që tash katër vite nuk po kryhet dhe janë ndarë 1 milion euro. Po shihet se bëhet për çështje elektorale.

Sa i përket RTK-së, ka mbetur si problem përderisa nuk kemi të zotë me ndryshua Ligjin e RTK-së. Në pjesën e financimit do të ballafaqohemi me problematikën e ndarjes së mjeteve dhe shumë buxhetore. Sa i përket ndarjes së shumë prej 1.4 milion euro për RTK-në, duhet ndryshuar pjesa tekstuale sepse atje figuron saktë shuma 11 milionë euro dhe me këto mjete shtesë shuma bëhet 12.4 milionë euro.

Safete Hadërgjonaj – do të doja në Komisionin për Buxhet dhe Financa të ruhet fryma e punës, gjë që është bërë deri më tani, pasi që kam pasur fatin me qenë në vazhdimësi në këtë komision, ndërsa kur kemi shkuar në seancë kemi bërë politikë. Do të doja që ne komision të bëhet punë sepse është komisioni me i rëndësishëm në Kuvendin e Kosovës dhe të gjithë politikat zhvillimore të vendit tona m'varen pikërisht nga ky komision dhe puna e cila bëhet këtu.

Ndryshimet të cilat janë bërë në rishikim të buxhetit unë i kam pa si të shpejtuara, në mënyrë që të ruajmë stabilitetin makrofiskal dhe e përgëzoj ministrin për punën që ka bërë dhe do të doja ta vazhdoni punën e mirë që e keni bërë në këtë ministri.

Periudha e stagnimit të formimit të institucioneve ka pasur ndikime edhe në buxhet, respektivisht mosratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare financiare siç janë paraparë me klauzolën e investimeve dhe përmes këtij instrumenti janë paraparë mbi 100 milionë euro investimet që nuk kanë arritur të realizohen.

Kryetari i komisionit tha se rishikimi është dokument evidence e kontabiliteti, por ne jemi përpjekur kur kemi miratuar buxhetin për vitin 2017 që të mos bëjmë buxhet evident e kontabiliteti, mirëpo, për këtë duhet komunikuar me ish-ministrin e financave. Një gjë që ka filluar të instalohet si praktikë në vitin e kaluar dhe po e shoh edhe me këtë rishikim të buxhetit, është rishikimi i investimeve kapitale. Unë mendoj që është dashur të hiqen ato projekte nëse nuk janë zhvilluar procedurat, por të mbesin si të evidentuara si projekte me buxhetin e ndarë për vitin e ardhshëm. Por heqja e projekteve që është në interes të qytetareve, nuk konsideroj që është diçka e mirë. Ajo çfarë kam vërejtur është mosrealizimi i projekteve në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ministrinë e Kulturës, që janë dy dikastere që kanë pasur më shumë projekte të planifikuara por që nuk janë realizuar. Fillimi i procedurave për projektet kapitale duhet të realizohet me kohë e që të jenë mjetet faktikisht të realizuara. Projektet të cilat planifikohen në buxhet, nuk duhet të fillojnë të realizohen vetëm kah i kemi komunat tona, por duhet të jetë një buxhet i planifikuar dhe realizuar mirë dhe në interes të të gjithë qytetarëve.

Unë konsideroj që është diçka e mirë që janë siguruar mjetet e veteraneve të luftës sepse nuk ka qenë e lehtë për këtë periudhë të shkurtër për ti siguruar ato mjete. Por, po ashtu, jam edhe udhëtarë që qeveria duhet ta merr seriozisht të bëhet një rishikim i këtij procesi sepse jemi duke krijuar njerëz parazitë. Duke e ndarë këto para për statusin e veteranëve, ndoshta një ditë nuk kemi me pas punëtorë, duke punuar në sektorë të ndryshëm për me e ruajt pagën që e merr si veteran. Pas problemeve që kanë ndodhur, konsideroj se shumë shpejt ligji duhet të rikthehet në Kuvend.

Sa i përket RTK-së, ka qenë një iniciativë e Kuvendit për me e ndryshua ligjin dhe do të duhë ta zgjidhim problemin e financimit të këtij mediumi publik para miratimit të buxhetit 2018 sepse nuk është mirë që RTK-ja të mbetet në pozicione të tilla e kushdo që te vjen ministër me ia caktua se sa mjete me i pas RTK-ja. Kjo duhet të rregullohet me ligj.

Blerim Kuqi - Siç e dimë ky është një vit i dyfishtë zgjedhor dhe duke pasur parasysh vonesat e kuptoj ministrin dhe zyrtarët tjerë që e kanë pasur vështirë, sidomos në këtë ambient që ata punojnë. Përveç që kanë tërhequr 45 milionë nga investimet kapitale, unë mendoj që pjesa tjetër ka me shkua në suficit duke i pasur parasysh procedurat e tenderimit. , duke pas parasysh edhe dokumentin që është hartuar, është hartuar nga Ministri i me parshim diku para një muaji për këtë arsye është dashur te sillet një dokument shtese rreth realizimit te te hyrave. Tani do të vjen edhe buxheti i vitit 2018 që është me rendësi se ku po orientohen programet. Ajo çka është me rendësi për mua me e pa edhe një herë se sa është afati kohor me dërguar një qarkore rreth projekteve kapitale, si dhe te njoftohemi për projektet që janë me bashkëfinancim me organizatat ndërkombëtare siç janë marrëveshjet me USAID-in, KFW si dhe me organizata Zvicerane. Pyetje tjetër qe s'e kam të qartë: pse është parapa me zë të veçantë çështja e humbjes së Gjykatës së Arbitrazhit. Po ashtu edhe Projektet që janë të zotuar me procedura normale nuk po mund të bëhen pagesa.

Kryetari – Të fajësohet qeveria e kaluar për vonesën e rishikimit të buxhetit është absurde.

Mërgim Lushtaku - Së pari, ne e dimë gjendjen aktuale pse ka ardhur deri te një rishikim i vonshëm i buxhetit dhe në këtë kontekst e kuptojmë këtë nxitim. Sigurisht ndarjen e 26 milionë eurove, por edhe për rritjen e buxhetit të RTK-së E di që jemi në fazën përfundimtare të vitit, por duhet pasur parasysh kontratat që janë lidhur për projektet e caktuara, të shtohet buxheti dhe të vazhdojë buxhetimi. Për rrugën Komoran-Skenderaj, nuk është bërë ndonjë lidhje e kontratës dhe presim që të bëhet lidhja e kontratës dhe të vazhdojë buxhetimi i projektit dhe gjithë asaj zone. Disa pika që i kam evidentuar realisht nuk kanë në këtë buxhet. Buxheti është i Republikës së Kosovës dhe nuk i takon vetëm një partie dhe në këtë frymë unë e di që ministri i financave e ka këtë gjë parasysh, por në të njëjtën kohë i përgëzojë si ministri në zhvillimin e procedurës së shpejtë në rishikimin e buxhetit për të mundësuar funksionimin e mirë të institucioneve në kryerjen e detyrave të tyre.

Dardan Molliqaj - Unë nuk e kuptoj znj. Hadërgjonaj që thotë të mos bëjmë politikë, por ne jemi deputetë të zgjedhur si njerëz politik dhe unë nuk kam ardhur me konkurs. Jam ekonomist, mua me ka caktuar partia në këtë komision. Prej përvojës dhe bindjeve të mia e di që nuk ka ligj më të rëndësishëm se buxheti, por nuk di prej përvojës time e prej bindjeve te mia, ku ka ligj më të rëndësishëm se buxheti e të thotë ish- kryetarja e komisionit e deputetja e opozitës, a është kjo veç sa për ta thënë një fjali apo përnjëmend beson kështu. Nëse e beson, të lutem shpjegoma se më duhet me i ndërrua krejt bindjet e mia. Buxheti nuk është bllokuar prej opozitës, mund te themi se opozita i ka bllokuar disa marrëveshje apo edhe disa seanca por buxheti është votuar me apo pa dëshirën tone. Buxheti siç shihet nuk është shpenzuar dhe do të shkojë në suficit, ky është problem i qeverisë që nuk bene planifikim të mirë të buxhetit.

Blerim Kuqi - Nuk thash se nuk ka vërejtje, Qeveria apo ministria e mëparshme, por unë thash se ka të bëjë me procesin e realizimit ose ankohet në realizimin e të hyrave dhe të dalat e jo për vonesë. Fajin e kemi bashkë me Qeverinë, që është sot dhe është e vërtet se jemi vonuar edhe nga momenti kur ka ardhur dokumenti në Kuvend e deri më sot. Sigurisht që buxheti bazohet në prioritete dhe duhet shikuar çfarë buxheti për me e luftua korrupsionin.

Kryetari - Po pajtohem në parim edhe u konsultova me znj. Hadërgjonaj dhe me administratën se nuk kemi vonesa sepse sipas Rregullores, në momentin që shpërndahet projektligji tek deputetët duhet

kaluar dhjetë ditë për tu plotësuar kushtet për shqyrtim në parim. Ne jemi marrë vesh që ta mbajmë mbledhjen për sot, pasi që kemi dashur që ministri të jetë i pranishëm, kur dihej se ai ishte në një udhëtim jashtë vendit.

Safete Hadërgjonaj - Z. Molliqaj, nuk e ka kuptuar mesazhin tim dhe nuk është mirë që brenda një mbledhje të Komisionit me komentu siç të konvenon ty, por komento drejt. Unë nuk e thash mos të bëjmë politikë, por të vazhdojmë punën e mirë dhe profesionale në komisione dhe politikë në seancën plenare. Ne nuk mund të largohemi krejt nga politika, por të vazhdojmë traditën e mirë të punës në këtë komision më të rëndësishëm, në mënyrë që të punojmë para së gjithash për interesat e qytetarëve, të përcaktohem në projekte dhe në prioritet të Kosovës dhe aty ku përfitojnë qytetarët të jemi këmbëngulës sepse nga buxheti varet perspektiva e vendit tonë.

Dardan Molliqaj – E ftoj administratën për transkriptim të diskutimit dhe do ta shohim se si ke fol.

Bedri Hamza – Bazuar në nenin 16 të Ligjit të Buxhetit, ka qenë domosdoshmëri që të adresohet rishikimi i buxhetit, pasi që brenda këtij ligji nuk ka mund të adresohen këto çështje sepse ndryshimet e kalojnë vlerën totale prej 5%. Besoj që pajtohem se ka qenë nevojë urgjente adresimi i çështjes se pagesave të veteranëve të luftës sipas ligjit në fuqi dhe ne nuk hyjmë me komentu a është i mirë apo i keq, por atë duhet zbatuar. Po ashtu, 50 milionë euro janë ndarë për projektin, i cili ka kontratën e autostradës në drejtim të Shkupit për punët e ekzekutuara. Nuk kemi ndonjë dallim të madh në strukturë. Shkurtime të projektet kapitale janë flokuar, po ashtu tek projektet tjera kapitale.

Zvogëlimi i buxhetit ka ndodhur kryesisht për dy çështje: e para është klauzola e investimeve, kur i referohemi buxhetit origjinal, e shohim shuma të paspecifikuara 76 milionë euro, e nuk ka emër projekti as datë dhe nuk është zhvilluar asnjë procedurë dhe as nuk mund të zhvillohet në këtë vit asnjë procedurë sepse me datën 31 tetor përfundon afati ligjor për prokurimin e projekteve kapitale dhe kjo është hequr. Pjesa tjetër ka të bëjë me mjetet nga AKP-ja dhe ne sot nuk e kemi draftin final të plotësimit-ndryshimit të Ligjit dhe këto mjete nuk ka mundur të merren pa u ndryshuar ligji sepse kemi pas mungese të institucioneve dhe s'ka pas Kuvend ku adresohen këto çështje.

Sa i përket projeksioneve makroekonomike, sigurisht që duhet të reflektohet. Kam biseduar me Departamentin e Makros mbi bazën e vlerësimit të këtyre e të institucioneve tjera nuk do të ketë ndryshim sipas rritjes ekonomike për vitin 2017 dhe në përgjithësi është vlerësuar se rritja ekonomike për vitin 2017 do të jetë 4%.

Sa i përket Programit me FMN-në ka skaduar në gusht dhe nuk kanë arritur të diskutohen çështjet e caktuara, por ne do të bashkëpunojmë në të ardhmen me FMN-në dhe ne e kemi diskutuar edhe rishikimin aktual.

Sa i përket shërbimeve shëndetësore, dihet se aktet nënligjorë nuk janë përfunduar dhe gjithmonë është diskutuar se cila është rruga më e mirë për të funksionuar sepse nëse nuk do të ecet mirë e mbarë paraqet një risk bukur të madh. Prandaj, jemi duke punuar me institucionet tjera me Bankën Botërore dhe Bashkimin Evropian dhe nuk ka asnjë mundësi që këto fonde ti shfrytëzojmë këtë vit.

Sa i përket pyetjes për kufijtë buxhetor, nuk kemi prek të hyrat pasi që presin që dy institucionet kryesore të hyrave buxhetore që janë Dogana dhe ATK-ja të realizojnë të hyrat siç janë planifikuar, sepse të hyrat janë diskutuar në fillim me programin e FMN-së dhe trendi i realizimit të tyre është i mirë. Sa i përket kërkesës së listës së projekteve kapitale do t'ua dërgojmë ato dhe atë në formë analitike. Ndërsa, sa i përket autostradës në drejtim të Mitrovicës, nuk është nisur asnjë procedurë dhe ne mund ti marrim mjetet në buxhet por tani janë të paekzekutueshme. E njëjta vlen për rrugën në Gjilan, Skenderaj e Drenas.

Sa i përket implikimeve në ekonomi, ka pasur efete pozitive në rritje ekonomike dhe në punësim. Është rritur shkëmbimi për qindra herë në mes Kosovë dhe Shqipërisë. Sa i përket shpenzimeve lidhur me vendime të formës së prerë të gjykatave, nuk është shuma 100 milionë euro, por është 5 apo 6 milion

euro dhe ne jemi të obliguar ti zbatojmë vendimet e prera të gjykatës. Sa i përket buxhetit të RTK-së, shuma është e rregulluar me Ligjin e buxhetit.

Kryetari - Më lejoni të theksoj se prej shumicës së komenteve që i dhatë këtu nuk ndërlidhen me punën tuaj se ministri profesionale dhe janë çështje në nivel të qeverisë. Klasifikimi i veteranëve nuk prek vetëm rishikimin por edhe buxhetin vjetor dhe është shqetësim i të gjithë anëtarëve të komisionit dhe ky klasifikim duhet të ndodhë sa më parë, në mënyrë që të ndalim rritjen e veteranëve dhe koston buxhetore që tejkalon shpenzimet e sigurisë, forcave mbrojtëse apo për shëndetësi. Një pjesë e madhe e rekomandimeve këtu shërbejnë si input se Qeveria të përshejtojë me energjinë e vetë edhe tek politika e prioritetit e saj. Rrugët kanë ndikim në rritje ekonomike por është çështja çka po investohet, por e jona është me i dhënë qëndrimet tona etike, si parti politike e si deputetë individualisht.

Dardan Molliqaj – Më lejoni të falënderoj ministrin që premtoi se ka me na dërgua listën e projekteve të lëvizura. E dyta atë që e tha kryetari i komisionit se buxheti është projektim i politikave dhe ju si ministri e financave nuk keni me i shkrua dëshirat e të tjerëve, por të tregoni se çfarë bënë e çfarë nuk bënë, se çfarë ka kuptim dhe çfarë nuk ka kuptim.

Te projektimi i buxhetit unë nuk mendoj se ka me pas punësim të qëndrueshëm dhe ne gati më shumë po hyjmë në treg të punës se sa po hapim vende të reja të punës. Sa i përket shkëmbimeve tregtare me Shqipërinë, duhet me pa raportin dhe jam i interesuar me e ditë a janë produkte të Kosovës dhe të Shqipërisë apo mallra transit.

Sa i përket përgjegjësisë për shërbyesit civilë që unë e kuptoj se shërbyesit civilë janë të pavarur dhe i nënshtrohen ligjit. Por unë jam i vetëdijshëm ministër edhe ti gjithashtu për afera të mëdha me miliona që shërbyesit e vogël civilë nuk guxojnë me i ba, por unë pajtohem me ty që policia, prokuroria nuk u kanë nuk kanë kryer punën fare mirë për me i ndjek këto raste të personave publikë dhe politikë, apo ministra. Ne e dimë që kemi një sistem katastrofal të drejtësisë, por ju nuk mund të thoni, jam ministër e çfarë ndodh në ministri nuk kam faj. Duhet kërkuar përgjegjësi dhe dhënë llogari sepse këto po dëmtojnë parandë publike, pasi që siç po shihet me këtë buxhet por marrim paratë prej investimeve e po i dërgojmë për pagesën e dënimeve për afera për të cilat dikush duhet të japë përgjegjësi.

Bedri Hamza - Ne dimë se kontribuuesi me i madh në rritjen ekonomike të vendit dhe në rigjenerimin e punësimit të qëndrueshëm është sektori privat edhe fokusi jonë do të jetë që ta vendosë më përpara sektorin privat. Investimi në infrastrukturën rrugore është i rëndësishëm për ekonominë dhe të thotë dikush se nuk është interes përfundimi i autostradës Prishtinë-Pejë, kur e dimë se çfarë pengesash na shkakton te mallrat e bizneseve apo Mitrovicë-Prishtinë. Prioritetet munden me qenë të ndryshme, mirëpo buxheti i vitit të ardhshëm do të jetë mbi bazën e programit të ndërtuar. Përveç lartësisë së mjeteve, ne gradualisht lëvizim për vlerën e pakos e cila është vlera e investimeve, fjala vjen nëse kemi investuar në shëndetësi apo arsim, cili është efekti i tyre.

Kryetari - Investimet kapitale duhet të rriten sa më shumë dhe në mënyrë transparente dhe kosto më të mirë dhe më të ulët të mundshme, përfshirë edhe fonde të tjera jashtë Kosovës për financimin e këtyre rrugëve, sepse deri me tani investimet në rrugë kanë ndikuar që shëndetësia e arsimit të mbesin mbrapa. Të mbesin mbrapa nuk bënë, por duhet një rritje dhe një zhvillim i ngadalësuar.

Dardan Molliqaj – Sa i përket buxheti shtesë të ndarë për RTK-në, nuk morëm informata a është kërkesë e tyre apo pse kanë shpenzuar më shumë? Sa i përket sektorit privat, të gjithë njerëzit që kam kontaktuar kurrë nuk janë ankuar, por ata kanë nevojë për ndihma të tjera nga qeveria prej aspektit legjislativ e deri te ndihmat financiare. Për mua të gjitha prioritetet janë të rëndësishme dhe më e rëndësishme është shëndetësia.

Bedri Hamza - Sa i përket RTK-së është brenda obligimeve ligjore dhe brenda shumës që është përcaktuar me Ligjin e buxhetit prej 11 milionë euro. Unë po them te biznesi privat rrugët janë vetëm një segment, ndërsa politikat fiskale, krijimi i kushteve të favorshme, administrimi i mirë i ligjeve janë po ashtu të domosdoshme të ndodhin

Kryetari - Është e pakuptimtë me e heq fondin e sigurimeve për shëndetësi e me e rritë thesin e veteranëve dhe duhet bërë riklasifikimi i tyre.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni me 5 vota Për, 3 Kundër dhe 1 Abstenim, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligji nr. 06/L-002, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2017.

3. Te ndryshme.

Kryetari - E keni marr Rregulloren e Kuvendit, por njëra prej diskrepancave është sistemi i raportimit. A ka anëtarë të komisionit në fusha apo sektorë të caktuar me e marr si prioritet për raportim në komision. Këtë ndarje besojë që e bëjmë gjatë javës në bazë të fushave dhe referencave në ministrinë dhe sektorët e caktuar.

Dardan Moliqaj – Kërkoj që ndarja e detyrave në bazë të Rregullores nëpër fusha të caktuara të shtyhet pas zgjedhjeve.

Kryetari - Çështja e dytë është se ne kemi planifikuar të organizojmë një takim apo punëtori me GIZ-in, ku do të diskutojmë për procesin e buxhetimit që për deputetët e rinj është me interes. Por kam pasur takim edhe me znj. Apostollova, shefe e Zyrës së BE-së në Kosovë e cila ka paraqitur krejt pikat e interesit të BE-së për komisionin tonë dhe do të diskutojmë një ditë tjetër.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30

**Kryetari i Komisionit,
Lumir Abdixhiku**

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit

